

VENDIM
Nr.1, datë 19.1.2007

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E RREGULLAVE TË PRAKTIKËS DHE
PROCEDURAVE TË ERE-S**

Në mbështetje të nenit 9 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 11 e 37 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.5.2004, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.1.2007,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.
2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve, si dhe këshilltari i Bordit të Komisionerëve për përpunimin e ndryshimeve të rregullave të praktikës dhe procedurave të miratuara me vendimin nr.26, datë 13.5.2004, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta